VENDIM
Nr. 258, datë 2.12.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "MER ENERGJI" SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2410/1prot., datë 21.11.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë "Mer Energji" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Mer Energji" sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2410 prot., datë 18.11.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Faqekuq 3", me kapacitet të instaluar 1300 kW, me vendndodhje në fshatin Vlush, Njësia Administrative Leshnje, Bashkia Skrapar, qarku Berat.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat "a" "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a" dhe "d"; për pikën 2.1 germa "a".

- Rezulton se shoqëria "Mer Energji" sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën e koncesionit të formës "BOT" (ndërtim-operim-transferim) "Për ndërtimin e hidrocentralit 'Faqekuq III'" nr. 2183 rep., nr. 1145/1 kol., datë 16.10.2018, si dhe kontratën shtesë të koncesionit nr. 15 rep., nr. 9 kol., datë 7.10.2022.

- Ka depozituar shkresën e shoqërisë së "Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. me nr. 216/3 prot., datë 12.1.2022, për miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes.

- Ka depozituar në ERE vendimin nr. 2, datë 3.10.2022, "Për miratimin e lejes 'Për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjitik shoqërisë 'Mer Energji' sh.p.k.'", të Këshillit të Basenit Ujor Seman, si dhe lejen për përdorimin e burimit ujor sipërfaqësor nr. 746 prot., datë 10.10.2022, e lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor (KBU) Seman. Vlefshmëria e kësaj lejeje është sipas kontratës së koncesionit.

- Ka depozituar vendimin për VNM paraprake, lëshuar më 24.3.2022, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin "Ndërtimi i HEC Faqekuq 3, me fuqi të instaluar 1300 kW. Kjo VNM parashikonte që shoqëria duhet të fillonte zbatimin në terren të projektit dhe fillimin e punimeve brenda datës 24.3.2024. Duke qenë se shoqëria nuk ka depozituar informacion në lidhje me fillimin e punimeve brenda kësaj date, vlerësohet t'i kërkohet ky informacion. Nëse shoqëria nuk ka filluar punimet e ndërtimit, duhet të depozitojë në ERE një VNM paraprake të re.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka depozituar në format fotokopje dokumentet e mëposhtme, ndaj në zbatim të nenit 8, pikës 3 të rregullores, duhet të depozitojë në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin dokumentat në vijim:

- Planin e biznesit;

- Kontratën e koncesionit të formës "BOT" (ndërtim-operim-transferim) nr. 2183 rep., nr. 1145/1 kol., datë 16.10.2018, së bashku me kontratën shtesë të koncesionit nr. 15 rep., nr. 9 kol., datë 7.10.2022;

- Shkresën e "OSSH" sh.a. me nr. 216/3 prot., datë 12.01.2022;

- Vendimin nr. 2, datë 3.10.2022 të KBU Seman dhe lejen për përdorimin e burimit ujor sipërfaqësor nr. 746 prot., datë 10.10.2022.

- Po ashtu nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni si më poshtë vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **germa "b":** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për administratorin e saj.

- **germa "c":** Shoqëria duhet të depozitojë strukturën organizative të saj.

Pika 1.3 Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **germa "a":** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin në lidhje me shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, duke iu referuar periudhës deri në momentin e aplikimit në ERE.

- **germa "b":** Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin vërtetues të aftësinë financiare për realizimin e plotë të investimit, referuar mënyrës së financimit.

- Përveç sa më sipër, vlerësohet që shoqëria të depozitojë informacion në lidhje me zbatimin nga ana e saj të afateve për ndërtimin e centralit, sikurse përcaktuar në kontratën nr. 2183 rep., nr. 1145/1 kol., datë 16.10.2018, e ndryshuar, e nënshkruar me MIE-n.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "MER ENERGJI" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali "Faqekuqi 3", me kapacitet të instaluar 1300 kW, me vendndodhje në Fshatin Vlush, Njësia Administrative Leshnje, Bashkia Skrapar, Qarku Berat.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë "MER ENERGJI" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti